



KONKURS PËR PUNË

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

Zyrtar për Logjistikë

Zyrtari për Logjistikë është përgjegjës për kryerjen e punëve logjistike që dalin nga kërkesat/nevojat e përditshme të zyrës dhe do t'i raportojë Udhëheqësit të Administratës.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për mirëmbajtjen teknike të zyrave, sallave, veturës zyrtare;
- Përgjegjës për furnizimin e zyrës sipas kërkesës nga departamenti i administratës;
- Përgjegjës për vozitjen e veturës zyrtare për nevojat e zyrës;
- Përgjegjës për përgatitjen, printimin dhe shpërndarjen e ID kartelave të studentëve dhe anëtarëve;
- Përgjegjës për pranimin dhe shpërndarjen e materialeve për trajnime (ligjërata, seminare etj.);
- Mbledhë dhe shpërndanë dokumente sipas kërkesës së personelit;
- Përkujdeset dhe mirëmban pajisjet e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Bashkëpunon me departamentet tjera si dhe kryen detyra dhe përgjegjësi tjera sipas kërkesës.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Patenta e shoferit e kategorisë "B";
- Njohuri në kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferuar;
- Aftësi të mira komunikuese dhe reprezentative;
- Aftësi organizative për punë të pavarur.

Dorëzoni CV-në tuaj në E-mail adresën: hr@scaak.org

Për pozitën: **Zyrtar për Logjistikë**

CV-të i pranojmë deri me **10.03.2026**

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.